

VENDIM
Nr.631, datë 15.9.2006

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.840, DATË 17.12.2004 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR VEPRIMTARINË E DREJTORISË SË SHËRBIMIT
TË TRUPIT DIPLOMATIK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 33 të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.840, datë 17.12.2004 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 3 të shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Përcaktimi i çmimeve dysheme të qirasë, që Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik zbaton për subjektet shqiptare jodiplomatike, dhe procedurat përkatëse bëhen në përputhje me aktet, ligjore dhe nënligjore, në fuqi, për përcaktimin e tarifave të qirasë për objektet e ndërmarrjeve shtetërore.”.

2. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Kapitali themeltar i Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik është 1 586 848 843 (një miliard e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë milionë e tetëqind e dyzet e tetë mijë e tetëqind e dyzet e tre) lekë.

Bilanci financiar i Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik miratohet, në fund të çdo viti financiar, nga këshilli drejtues, së bashku me raportin e auditimit nga ekspertët kontabël të pavarur, të miratuar nga Ministri i Punëve të Jashtme.”.

3. Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Tarifat e shërbimeve dhe çmimet e qirave, që Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik zbaton për Trupin Diplomantik, përcaktohen në përputhje me të drejtat e përfaqësive diplomatike dhe detyrimet e shtetit shqiptar, që burojnë nga marrëveshjet dypalëshe, dhe miratohen për çdo vit financiar, nga këshilli drejtues i Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik.”.

4. Pas pikës 10 shtohet pika 10/1, me këtë përmbajtje:

“10/1 Ngarkohet drejtori i Shërbimit të Trupit Diplomantik të bëjë regjistrimin në gjykatë, në përputhje me ligjet nr.7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore” dhe nr.7667, datë 28.7.1993 “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet, që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare”, dhe të kryejë regjistrimin e listës së inventarit të pronave, të dhëna në përgjegjësi administrimi, në mbështetje të vendimit nr.450, datë 16.6.2005 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik”.”.

5. Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. Vendimi nr.113, datë 26.2.1993 i Këshillit të Ministrave “Për veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik”, dhe aktet e tjera, të nxjerra në zbatim të tij, shfuqizohen.”.

6. Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“12. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si dhe institucionet e përmendura në pikën 9 të vendimit në fuqi, për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha